



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 136/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizje Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, për shkak të Shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**PRANOHET** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizje Vetëvendosje (LVV), dhe subjektit politik Lista Serbe, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 4.000 (katërmijë) euro, për shkak të shkeljes së kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, e cila detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

## **A r s y e t i m**

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizje Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se subjekti politik Lista Serbe ka publikuar një klip në faqen zyrtare të Ministrisë për Komunitete. Në këtë klip shihet personi i cili është kandidat për deputet nga radhët e Lista Serbska, ku bën thirrje që të votohet ky subjekt politik dhe kandidati i saj.

Për këtë, në kuptim të dispozitës në nenit 6.1 të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, shfrytëzimi ose mbështetja e ndonjë kandidati të subjektit politik përmes ndonjë burimi institucional të administratës publike qoftë e nivelit lokal apo qendror përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Sipas kësaj, Lista Serbska, konkretisht kandidati i saj me postimin e kësaj video ku bëhet thirrje të votohet Lista Serbe dhe kandidati i saj gjatë fushatës zgjedhore, ka shfrytëzuar dhe keqpërdorur pozitën e tij publike, rrjedhimisht ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 6.1 dhe 6.2 të Rregullës Zgjedhore 11/2013, si dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë sipas të cilit përdorimi i zyrave publike, burimeve ose personelit të cilitdo institucion në nivel lokal apo qendror me qëllim të mbështetjes së subjektit të zgjedhje është rreptësisht i ndaluar po ashtu sipas nenit 35.1 personi që mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund ta

përdorë atë zyrë apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave dhe nenit 35.2 ku thuhet se gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga shërbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik.

Parashtruesi i ankesës si provë materiale ka bashkangjitur fotografitë e faqës zyrtare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe linkun e faqës.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik Lista Srpska për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë deri më datë 08.06.2017 deri në ora 17:00.

Subjekti politik Lista Srpska gjer në ora 17:00 të datës 08.06.2017 nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë. Mos dorëzimi i përgjigjes në ankesë si dhe mos dorëzimi i saj me kohë, nuk është pengesë që PZAP-i të vendos lidhur me ankesën (neni 7.5 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it).

PZAP-i pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se

**- ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë materiale si dhe nga linku i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, PZAP ka vlerësuar se subjekti politik Lista Srpska me qëllim të promovimit të subjektit politik dhe kandidateve të tij ka bërë lansimin e klipit në faqen zyrtare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim gjë që është në kundërshtim shfrytëzimi ose mbështetja e ndonjë kandidati të subjektit politik përmes ndonjë burimi institucional të administratës publike qoftë e nivelit lokal apo qendror dhe përbën veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Më këtë rast, PZAP-i, vlerëson se subjekti politik i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 35 pika 1 të Ligjit për zgjedhje të përgjithme ku thuhet se *personi që mbanë pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërrmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje.*

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi mori parasysht shkeljet e lartpërmendura, dhe shqiptoj gjobën, duke u bazuar në nenin 120 par. 1 pika (c) LZP-së, nenin 3 pika 11 Rregullores për Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it, si dhe duke marr parasysht rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;

- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.136/2017 më datën 09.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit**

Rafet Haxhaj

***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.